



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 12.03.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr.APK-DPKI-06-3237/25, për zyrtarët publik znj. Mergime Morina - Emërllahu, Inspektore e Punës në Inspektoratin Qendror të Punës, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e konflikti të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur me pretendime për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të denoncimit nga një raportues i rastit, ka filluar procedura e shqyrtimit të konfliktit të interesit. denoncuesi ka ngrit pretendimet citojmë pjesë relevante nga kërkesa; "jam përfshirë në një proces disiplinor që ka rezultuar me vendimin nr.02/A/-330 të datës 09.08.2025 për shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje me shkrim". Ky vendim është iniciuar dhe motivuar për arsye personale dhe hakmarrje nga inspektorja znj. Mergime Emërllahu, me të cilën kam pasur më herët konflikt, dhe e cila në mënyrë të qëllimshme ka ndikuar në procedurat disiplinore ndaj meje. Konflikt interesi dhe mungesë paanshmërie; personi që ka ndikuar në procedurë znj. Mergime Emërllahu ka pasur më herët konflikt të hapur me mua dhe megjithatë është përfshirë drejtpërdrejtë në proces, ku ka marrë rol aktiv në proces. Shkelje e parimit të trajtimit të barabartë: për të njëjtën ndaj inspektore znj. Mergime Emërllahu nuk janë ndërmarrë masa për mosrespektim të orarit të punës e cila nuk ishte në zyre as në fillim të orarit si dhe as pasdite. Keqpërdorim i detyrës zyrtare: pozita e koordinatorit dhe ndikimi mbi procedurat janë shfrytëzua për të më dëmtuar

profesionalisht dhe personalisht. Motive personale: vendimi është rezultat i raporteve konfliktuoze, jo i veprimeve të mia profesionale, vendimi është bazuar në interpretime subjektive, jo në prova të qarta dhe të vlefshme”.

Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe përkitazi me rastin konkret konstaton gjendjen faktike si në vijim;

Muhabere Konesha, në cilësinë e zv. Udhëheqëses të sektorit të koordinim në rajonin e Gjilanit kishte iniciuar procedurë disiplinore ndaj Mergime Morina Emërllahu sipas shkresës nr.03/32 të datës 01.10.2024.

Me datë 07.08.2025 znj. Mërgime Morina Emërllahu, ishte caktuar zëvendësuese Udhëheqëse e sektorit të koordinimit në rajonin e Gjilanit përmes komunikimit zyrtar (e - mail).

Përmes komunikimit elektronik të datës 08 gusht 2025 znj. Morina -Emërllahu, kishte njoftuar stafin se; sot të realizoni nga një inspektim që do të autorizoj në vazhdim dhe pjesën tjetër të kohës mund të angazhoheni në trajtimin e lëndëve, qofshin ato aksidente, ankesa apo ri inspektime.

Me datë 11.08.2025, përmes e mailit zyrtar znj. Morina – Emërllahu, kishte kërkuar nga Udhëheqësi i sektorit të koordinimit në rajonin e Gjilanit të merren masa ndaj znj. Muhabere Konesha, Inspektore në Inspektoratin Qendror të Punës, për arsye të shkeljeve të pretenduara të Ligjit nr. 08/L-187 për zyrtarët publik.

Me vendimin nr.02/a-330 të datës 19.08.2025, Udhëheqësi i Sektorit të koordinimit në rajonin e Gjilanit, ndaj inspektore Muhabere Konesha, i shqipton masen disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Zyrtarja Muhabere Konesha, kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit pas shqyrtimit të pretendimeve për konflikt interesi, informacioneve, sqarimet dhe dokumentacionin e pranuar sipas detyrës zyrtare vlerëson se;

Me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*, ndërsa neni 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”*.

Në nën paragrafi 1.6, të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar se: *“Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë [...]”,* s dhe me nën paragrafin 1.12 të këtij neni, i cili e definon nocionin vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*.

Zyrtarja znj. Mergime Morina - Emerllahu nuk është gjetur në situatë të konfliktit të interesit me rastin e parashtrimin të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore sepse nuk është gjetur të ketë pasur interes privat që ndikon në kryerjen me paanshmëri të detyrës publike dhe as shfrytëzim të funksionit publik për interes privat. Inicimi i kërkesës është bërë mbi bazën e rrethanave të zhvilluara të procesit të punës me pretendime për kryerjen apo mos kryerjen e detyrës zyrtare çështja e parashtruar për shqyrtim në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Zyrtari z. Skender Hoda, Udhëheqës i Sektorit të Koordinimit në rajonin e Gjilanit, nuk është gjetur në situatë të konfliktit të interesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore vërejtje me shkrim sepse në këtë Vendimmarrje, nuk është gjetur interes privat i zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit publik siç është përcaktuar në nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Zyrtari në fjalë nuk ka lidhje familjare me zyrtaren Mergime Morina – Emërllahu, kjo është konfirmua nga Agjencia për Regjistrimin Civil të Kosovës.

Pretendimet për diskriminim, mos inicim procedure për shkelje të orarit të punës, trajtim jo të barabartë në marrëdhënie të punës, keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk janë trajtuar nga Agjencia për arsye se këto pretendime nuk hyjnë në kuadër të fushëveprimit të përgjegjësive të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

II. Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajftueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: palët e pakënaqura kanë të drejtë të inicojnë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarëve publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

